



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr. 03-156
11.04.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagji 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 184/13, 13/14, 44/14 , 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18 , 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 64 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Teksti i pastruar) ark.nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr.10-1388/1 datë 27.3.2023 dhe Konkluzioni ark.nr. 02-1777/3 datë 10.4.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 13- të mbajtur më 10.4. 2023, miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep, për shkeljen e kryer të nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), në atë mënyrë që në shërbimin programor televiziv, të transmetuar më 2.3.2023, në dy emisione nuk është ofruar përkthim në gjuhën maqedonase, përkatësisht: në programi "Këngët maqedonase në Dobrinishtë, Maqedonia Pirinit 2", fjalët e të ftuarve janë transmetuar burimisht në gjuhë bullgare, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase, dhe një pjesë e emisionit "Hani Byrek", gjegjësisht pjesë e intervistës me Xhejson Miko është transmetuar origjinal në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr.10-1388/1 datë 27.3.2023 e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr. 1.

2. URDHËROHET SHTR TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi ta harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik në aspektin e respektimit të dispozitave nga ligji i përmendur, lejet, vërtetimet e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të tij, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në bazë të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit janë të obliguar të transmetojnë programin në gjuhën maqedonase dhe alfabetin kirilik, dhe në rastet kur programi është i dedikuar për komunitetin që nuk është shumicë, në gjuhën dhe shkrimin e atij komuniteti..

Në kuadër të kompetencave të saja ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 27 mars 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep, transmetuar më 2 mars 2023, në nivel shtetëror, në të cilin ka konstatuar shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja e rregullt është konstatuar se më 2 mars 2023, në shërbimin programor televiziv të SHTR TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep, në dy emisione nuk ofrohet përkthim në gjuhën maqedonase, përkatësisht: në emisionin "Këngët maqedonase në Dobrinishte, Maqedonia Pirinit 2", fjalët e të ftuarve janë transmetuar burimisht në gjuhën bullgare, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase, dhe një pjesë e emisionit "Hani Byrek", gjegjësisht pjesë e intervistës me Xhejson Miko është transmetuar burimisht në gjuhën angleze, pa u ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga pika 1 i këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr.10-1388/1 datë 27.3.2023 e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr. 1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep, dërgoi Shkresë ark.nr.10-1388/2 datë 29.3.2023, me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr. 10-1388/1 datë 27.3.2023, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt më 29.3.2023. Në afatin e paraparë, SHTR TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 10.4.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konstatoi se ndaj SHTR TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep t'i shqiptohet masë – vërejtje publike .

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 64 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr.10-1388/1 datë 27.3.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1777/3 datë 4.10.2023, për konstatim të mosrespektim të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën mbajtur me 10.4.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHTR TELEVISION SONCE SHPKNJP Prilep dhe urdhërohet që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryehet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer të programit ark.nr.10-1388/1 datë 27.3.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit aadministrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.